

## STATUTI

### I SHOQËRISË TREGTARE VIP COMPANY SH.P.K ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 20.11.2019 (dymijë e nënëmbedhjete), ortakët:

Z. Çelnik Zere , i biri i Rushit , i lindur më 19.10.1979 në Babjen, Korce, e banues në Maliq në Rrugën L.Qesarat, Rr.Shkoze, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaporte nr BD117817L, me nr. personal H91019124E , datë leshimi 26.01.2017;

Z. Klajdi Laçi, i biri i Agron, i lindur më 07.05.1995 ne Çorovode, Skrapar e banues nü Therepel , Skrapar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërmjostimi nr 031158114 , me nr. personal J50507003T, datë leshimi 13.06.2011;

Kanë vendosur themelimin e shoqërisë VIP COMPANY SH.P.K. me terma si me poshtë:

#### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare VIP COMPANY SH.P.K. tregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nt. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjisacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërisë Tregtare

#### NENI 1.

##### Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë shtrihet në fushat e mëposhtme:

Import- eksport dhe tregetim e magazinum me shumice dhe pakice i gjithe gumes se artikujve ushqimore, pijeve alkollike dhe jo alkollike, kafes dhe nenprodukteve te saj, detergjentre dhe produktet e kozmetikës. Import - Eksport dhe tregeri me shumice dhe pakice i artikujve industriale, pajisjeve elektrorashtepiake, kompjutera dhe aksesore, artikuj dhe materiale per ndertim, pajisje elektrike, elektronike, hekur, skela, pjese këmbimi, materiale plastike, bime medicinale, mobileri, lende drusore, materiale tekstile, mermer, granit, te gjitha llojet e plakave , xhamia e panele xhami e te ndryshme, lerra dhe nenproduktet e saj

hapjen dhe administrimin te marketeve, supermarketet. Import esport i lendeve te para qe kane te bejne me furnizimin e prodhimit me lende te pare dhe produkteve dhe makineri ne funksion te hotelive, njesive tregate te sherbimit etj. Import - Eksport , prodhim dhe tregerim i artikujve te bulmetit dhe nenprodukteve te tij, prodhime bimore dhe shtazore, tregeri vajit te ullirit, vajit ushqimor dhe joushqimor, margarines, etj..

Prodhim dhe tregtim me pakice dhe shumice te produimeve te brumit dhe nenprodukteve te tij, prodhim dhe tregtim te miellit dhe nenprodukteve te tij si dhe te produhuara nga te trete, prodhim dhe tregtim te produktave ushqimore si dhe te produhuara nga te trete. Aktiviteti ne fushen e sherbimeve dhe tregtise si: pasticeri, bar kafe, kreperi, fast food, pije freskuese, lavanteri dhe lavazh per mjete e produkte te ndryshme. Agjensi turistike dhe udhetimesh, agjensi ndermjetesimi dhe marketingu. Dhenie me Qira te automjeteve.

Ne fushen e ndertimit per zbatim, ndertime civile ekonomike, punime dhei, sisteme, terracime prodhim elementesh te parafabrikuara betoni dhe beton armeje, komplekse me instalimet e nevojshme per to, ndertime civile, industriale turistike, bujqesore etj, sherbime inzlime elektrike, hidraulike, karpenterie, e gjithcka ka lidhje me to.

#### NENI 2.

##### Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do te paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj **VIP COMPANY SH.P.K.**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën: Rr. Qemal Stafa nr. Pasurie 2/542 N18 zona kadastrale 8150

#### NENI 3.

##### Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe mund te ndryshohet një apo disa herë, sipas një vendimi të asamblesë së ortakëve.

#### NENI 4.

##### Regjimi Juridik i Shoqërisë.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë se tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimitaria e saj i nënshtronhet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përpunje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përpunje të plotë me dispozitar e Aktit të Themelimit dhe të Starurit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse ligjore. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulen e saj.

## II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.

#### NENI 5.

Ortakët nuk mbajnë përgjegjesi për humbjet e shoqërisë perveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhin në kapitalin filletar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronesi të shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetersohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.



## NENI 6.

### Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortakët jepin kontributin e tyre në shoqeri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogarirë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet me shtetin dhe për gjendjen e securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjerrë të brendshëm të shoqërisë, me përfashitëm të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbroj, i cili në rast se do të përhapej personave të paautorizuari do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk tregzon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të sigurnara deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjera. Ata gjëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpilen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj të përcaktuar në nenin I.

## NENI 7.

### Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët, e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paafresisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, pëtë të përbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

## NENI 8.

### Ndalimi i konkurrencës

Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jene të punesuar në shoqëri të tjera, që ushtronin veprimtari në të njëtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit pëtë ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Ndalimi i përmendor më sipër mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posacëm, të dhënë nga asambleja e përgjithshme me 51% të votave.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendor në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritisë së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë se cilir prej ortakëve:

- a) të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të rrij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përsitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kredite, që kanë trjedhur nga kryerja e veprimeve per llogari të personave të tretë.

#### NENI 9.

##### Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortaketë e tjere ose shoqëtia kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëtia i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrrojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblecë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njostumin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të atsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të atsyeshme, nëse pas njoftimit te largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblojë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjere që shkaktuuan largimin e rrij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërbimin e dëmit të pësuar.

Ortaku mund të largohet nga shoqëria me pëlqimin e orrakëve të tjere. Në këtë rast ortaku që largohet nga shoqëria ka të drejtë të marrë rimbursimin e pjesmarries së tij ne në përpjesëtim me pasurinë e shoqërisë. Ky i fundit përcaktohet nga administratorët bazuar në vlerën e tregut të saj ne momentin e deklaratës së largimit (vecançisht duke marrë ne konsiderarë gjendjen pasurore të shoqërisë, të ardhurave të saj, të vlerës së të mirave materiale, dhe jomateriale që ka ne posedim, të gjendjes së saj ne treg dhe të çdo rrëthane dhe kushti tjetër që mbahet ne konsideratë me qëllim përcaktimin e vlerës së pjestmarries ne shoqëri). Rimbursimi i pjesmarries për të cilat është ushtruar e drejra e largimit duhet të zbatohet brenda 6 muajve nga njoftimi i ortakut shoqërisë.

#### NENI 10.

##### Përashtimi i ortakut

Ne baze re një vendimi te zakonshem, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykates përashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shrimi ne kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara ne Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përashtimin e ortakut, por pa u kufizuar ne ro, rastet kur ortaku:

- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjere;
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- përfshihet ne veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtarë dhe ortakut
- me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtarë te shoqërise.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pëzelluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet te përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërtimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërbimin e dëmit rë pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërbimin e dëmit rë pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të atsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padë për shpërbimin dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonë në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

### III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.

#### NENI 11.

Veprimitaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimitaria ekonomike ndërrohet mbi partiinet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

#### NENI 12.

Kapitali filletar i investuar nga Orrakët, përbën bazën e krijuarit të fondit themeltar të tijeteve të xhiros. Administratori i dotëzon Ortakëve dokumentin vërtetues për sasitë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.

Vlerësimi i kapitalit në naryrë është bërë nga Ortakëve Themelues në momentin e themelimit të Shoqërisë.

#### NENI 13.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përberë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lek, e ndarë në 2 (dy) kuora. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

- 1. Z. Klajdi Laçi* në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të vlerës së kuotave të kapitalin themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 50.000 lekë në kapitalin themeltar.
- 2. Z. Çelnik Zore*, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të vlerës së kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 50.000 lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga partnerët themelues në total. Vlerësimi dhë pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Partnerët Themelues në tast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ta.

#### NENI 14.

Pronësia mbi kuotat.

Kuotat e kapitalit dhë të drejtat që rrjedhin pës tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:



- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjeter të parashikuar në ligj.

#### NENI 15.

##### Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave,

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gjëzojnë të drejtën e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

#### NENI 16.

Kuotat mund të anullohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkates dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhën me anulimin e tyre.

Rastet e anulirimit të kuotës do të përcaktohen nga rregullore të posaçme, të miratuar nga Asambleja e Ortakëve me 75% të votave. Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktitmeve të këtij statuti.

#### NENI 17.

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asamblea e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm kete vendim mbi kërkesën e kreditoreve.

#### NENI 18.

##### Fondet rezerve

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojar e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mijetet e veta financiare për shlyetien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

#### NENI 19.

##### Përdorimi i të ardhutave neto.

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëta për kryerjen e çdo lloj akriviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që trittin kredinë për investime, pagat e shpërbërës, përdoret nga Ortakët, sipas qellimeve të tyre.

## NENI 20.

### Bilanci, plani finanziar.

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valurë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me arë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

## NENI 21.

### Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruuar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

## NENI 22.

### Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t'u shpërndaje fitime ortakëve, vetëm nese pas pagimit të dividendit:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka akrive likvide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kerkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë te akrësish paguese, e cila konfirmon shprehimi i se shpërndarja e propozuar e dividendeve përmبush kërkësat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendeve nuk i përmبush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë rë pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht pëtpara shoqërisë për kthimin e dividendeve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividende, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendeve, që u janë shpëndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikates, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të tretthanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

## IV. ORGANET E SHOQËRISË.

### NENI 23.

#### Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Përgjithshme. Asamblea e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{2}{3}$  e votave të rastës së mëposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve;

5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statut;

Për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asambleje;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertit kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorer, likuiduesit dhe ekspertit kontabël të autorizuar;
- mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimitarise;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarise;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

**NENI 24.**

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasut, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
- Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët rë cilët përfaqësojnë rë paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpala Asamblesë së Përgjithshme paraqiter një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavatur.


Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre Asamblea e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërcitje për veprimitarinë e administratorëve.

**NENI 25.**

**Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbhajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e dirës e r'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpala dates së parashikuar për mbledhjen e asamblee.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



## NENI 26.

### Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonishtme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse m arrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme verëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mijte elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet per shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtar e votave të orrakëve pjesemartës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çeshtjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesemartjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mijete të ndryshme komunilimi, perfshirë mijeter elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuorës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërbimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejave.

## NENI 27.

### Proçesverbal i mbledhjes se asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të registrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbal i mbledhjeve duhet të përmbarë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbaleve, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i hashkëlidhet edhe lista e pjesëmarresve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbaleve.

## NENI 28.

### Hetimet e posaçme

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë njëheti të posaçëm përfundimisht të parregullsisë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimitarës tregtarë. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarut i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 përfundimisht të votave në asambleen e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut ose cilidë kreditori i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavatur të fushës, kur ka dyshime të bazuara përfundimisht të ligjt ose rë statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja përfundimisht të ekspertit të pavatur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqites së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kërkuar herim të posaçem, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregallt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Në rastet e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë ti këtkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e këtyre vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjë apo statutit.

Ortakët rë cilët përfaqësojnë të pakrën 5% të totalit rë votave në asamblenë e përgjithshme apo secili kreditor i shoqërisë mund ti kërkojë asamblesë së Përgjithshme shfuqizimin si më sipër, ose ata mund rë procedojnë vetë përpara gjykatës brenda 30 ditëve nga refuzimi I asamblesë për ngritjen e padisë. Nëse Asamblea e Përgjithshme nuk merr një vendim brënda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

Procedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfqësues I posaçëtn I shoqërisë I emëruar nga Asamblea e Përgjithshme. Kreditorët apo ortaker e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykarës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime në lidhje me të për përfaqësinun e tij jo në interes të shoqërisë.

Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve rë parregulla do të tregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit "Pët Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

## V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 29.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bisnesit. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund rë emërohen si administratorë të një shoqëtie të kontrolluar e anasjelltas.

Administratori i Shoqërisë VIP COMPANY Sh.p.k. do të jetë Z. Klajdi Laçi, i biri i Agron, i lindur më 07.05.1995 ne Çorovode, Skrapar e banues në Therpel, Skrapar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Lejëmjoftimi nr 031158114, me nr. personal J505070031; datë leshimi 13.06.2011; Shoqëria do të përfaqësohet përpata ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjeter publik apo privat dhe në marrëdhënje me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushton të drejtat e tij në përpunë me Scharatin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### NENI 30.

#### Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojë shoqërinë tregtare;



3. kujdeset përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajt bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozitimet përmbytjen e fitimeve, të pataqesë këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
5. krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për tretuanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratim;
7. raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë përmiratim;
8. kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
9. të thërrasë asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blej nga një orrak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të cerritikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë deryrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme cakton me shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Rregullohet e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojet administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përshtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënive kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **NENI 31 Shpërbimi i administratorëve**

Shpërbimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të janë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërbimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm rë asamblesë së përgjithshme.

Shpërbimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërbimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërbimit, shpërbimi individual dhe efekti vjetor i shpërbimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **NENI 32 Ekspertet kontabël**

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përparrë rasteve të përcaktuara në ligj. Funksionin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Ekspertet kontabël mbajnë përgjegjësi përmbytjen e tregullr të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë.

Ara përgjigjen përmbytjen që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullit e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

## VI. MARRDHĒNIET E PUNĒS

NENI 33

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Akut të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqeri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës tregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 34

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shikojnë Shqipërisë përfshi te tyre që përgjigjen para së cilisë.

#### VI. PRISHJA E SHOOĒRISË LIKUDIMI

NENI 35

Kje Shogëri do të prisht në rast kur:

1. Kur përfundon kohëzgjatja e themelimit;
  2. hapen procedurat e falimentimit apo në rast të pamjaftueshmerisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është vjedhur pezullimi i veprimitarise në përpunhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombetare të Bisnesit";
  4. në rast e tjera, të parashikuara në statut;
  5. në raste e tjera, të parashikuara me ligj;
  6. për çdo shkak tjerër të vendosur nga asambleja e ortakëve;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrit nezi Administratorët.

NENI 36.

## Likuidimi i shoqërisë

Pritishja e shoqërive tregtarë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësise paguese, me perjashtim të rasteve kur është nisut një procedurë falimentrimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, edo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykata, pët të cakruar një likuidues.

Cdo person i interesuar, ka tē drejtë t'i kérkojë gykates zevendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsyë të mjaftueshme pët tē dyshuar se likuidimi i tregullt i shoqëritë mund tē cenohet nga likuiduesit e emëtar si më sipër. Kërkesa duhet tē depozitohet ne gykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me veprim gjykate

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të rrejtat kushte, të parashikuara në dispozitar për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Bistnesit të dhënat e likuiduesve të parë që tafsat e tyre, përfundimisht shoqëritë, që bësloj me

dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashut, Qendrën Kombëtare të Bisnesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit".

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënim "në likuidim". Likuiduesit duhet të stojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituat pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 diteve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimir të tij.

#### NENI 37.

#### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pasblyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryej edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributer e pasblyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykates përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

#### NENI 38.

#### Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfutidimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashut, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet mirarohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### NENI 39.

#### Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetur, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me pëtjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthchen ortakëve apo aksionarëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Bisnesit përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

#### NENI 40.

#### Likuidimi i thjeshtëzuar

Shoqëria mund të likuidohet nëpermjet një procedure të përshtpjta, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përparrë gjykates përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyerë e janë irregulluar të gjitha marrëdhënet me punëmarresit.



Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përvec administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në menyre solidare deri në shumat e marra.

## VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

### NENI 41.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit.

### NENI 42.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimi i këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### NENI 43.

Ky Statut përpilohet ne 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe u rëndshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues përparrë noterit të vendit të themelimir.

## ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE VIP COMPANY SH.P.K

Z. KLAJDI LAÇI



Z. ÇELNIK ZERE

